



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

C.nr.431/2017

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, departamenti i përgjithshëm, e përbërë nga gjyqtari individual Ragip Kadriu, në çështjen juridike të paditësit: **MH** me adresë ... në ..., kundër të paditurës: Universiteti ... të cilën e përfaqëson **ES** sipas autorizimit me shkrim, baza e kontestit: Padi Anulim Vendimi dhe kthimi në punë, pasë mbajtjes së shqyrtimit kryesore dt.02.04.2019, bie këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET** kërkesëpadia e paditësit: MH në ... , me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të anulohet vendimin e të padituesit Universiteti ..., me nr. te protokollit 832/005 te dt.... dhe të obligohet e paditura që paditësin ta kthejë në pozitën e punës sipas kontratës ekzistuese të punës me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës përfshirë edhe kompensimin e të ardhurave personale, si dhe të i'a bëjë kompensimin e të ardhurave personale nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës në tërsi e PA BAZUAR.
- II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e parashtruar, thekson se me palën e paditur kanë lidhur kontratë punë me Nr... e datës ..., në pozitën Asistent, e cila Kontratë ka pasur kohëzgjatje prej ... deri me datë ... Për 3 decenie d.m.th 29 vite ka punuar tek e paditura dhe ka dhënë kontributë të pa kursyer, për ngritje profesionale duke mos u kursyer, si dhe duke sjell kapacitet e larta për punën shkencore dhe profesionale. Me datë 30.05.2017 e paditura Universiteti ... në ..., ka lëshuar vendim Nr.Prot... lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së Punës i lëshuar nga Rektori z.**AM**. Paditësi në afatin ligjor ka ushtruar Ankesë kundër vendimit të paditurit Universitetit ... në ..., e njëjta është refuzuar si e pa bazuar. Për t'i plotësuar kërkesat e Universitetit e ka lajmëruar punën disa herë, si punë dytësore duke u paguar vetëm për atë pjesë, me datë 05.06.2017, për të vërtetuar se a ekziston ndonjë vendim i tillë, ka vizituar zyrën e personelit në rektorat, ku ka kërkuar dosjen me

nr.42, por i njëjti ka ngelur i zhgënjyer pasi që në dosjen e tij përveç kontratave të punës dhe disa dokumente të vjetra, mungonin kopjet e doktoratës dhe magistraturës, si dhe të gjitha deklaratat me anë të së cilave e ka deklaruar punën primare dhe sekondare sa herë është kërkuar nga menaxhmenti i fakultetit. Pozita në AKP, si post i lartë publik, dëshmohet edhe me obligimin ligjor për deklarimin e pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit, në bazë të Ligjit Nr.04/1-050 për deklarim, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik, si dhe bazohet edhe në Rregulloren nr.06/2012 për pozitat e larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, në pozitën Menagjer i Zyrës Rajonale në Mitrovicë, duke u zgjedhur me Akt-Emrim me Nr. Ref.95/MI 1 të datës 01.07.2014, ka deklaruar pagën primare, pozitë kjo e karrierës, e cila është e pa afatshme dhe bazohet në Ligjin e Punës Nr.03/L-212 dhe Ligjin për shërbyesit Civil Nr.03/L-149, gjë për të cilën ka biseduar me menaxhmentin e Universitetit, po ashtu edhe me AKP-n. Njoftimin e Këshillit Drejtues të Universitetit të ... Nr.443/005 të datës 31.03.2017, me anë të cilit ishte njoftuar i gjithë stafi akademik, ku ndër të gjitha i fton të gjithë personelin akademik të paraqitet dhe deklarohet për punë tjetër: (cituat) “Personeli akademik që përveq në Universitetin e ... ka edhe një marrëdhënie tjetër pune me ndonjë institucion brenda apo jashtë vendit, OJQ, kompani, publike apo private, avokaturë, noteri, përmbarues privat dhe të ngjashme, obligohet që deri me datë 31.04.2017 të përcaktohet nëse do të ketë marrëdhënie të rregullt pune me Universitetin e ... apo jashtë Universitetit”. Po ashtu i njëjti pretendon se shkeljet në Universitetin e ... këtë rast pala paditëse janë më të mëdha pasi që nga kjo e fundit nuk është respektuar vendimi i Këshillit Drejtues, i cili ndër të tjera thotë: (cituat) “Personeli akademik si në pikën 4 dhe 5 të këtij vendimi, në rast të pezullimit të drejtave dhe detyrave nga marrëdhënia e punës kur zgjidhet apo emërohet në funksione publike pas përfundimit të mandatit, ka të drejtë të kthehet te punëdhënësi brenda afatit prej pesë ditësh pa pasur nevojë të shpallet konkursi publik”. Sipas të paditurit vetëm 5(pesë) profesor nga i tër stafi akademik në Universitet, janë afektuar, duke pretenduar se nuk janë afektuar një numër i konsiderueshëm i stafit akademik, duke bërë shkelje ligjore që e ndalon diskriminimin në punë. Pra Universitetit i ..., gjegjësisht Rektori i Universitetit, bazuar në vendimin KD-së, Nr.832/005 të datës 30.05.2017, nuk e ka respektuar Ligjin Nr.04/L-037 Për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, me saktësisht neni 28, pika 6. Po ashtu Universiteti i ka vepruar kundër dispozitave ligjore, neni 70, pika 1.1 të Ligjit të Punës, e cila arsyetohet me shkaqe ekonomike, teknike ose organizative dhe arsyetimi për ndërprerje të kontratës, nuk është dhënë asnjë nga këto të cekura dhe bazuar në këtë nen.

Paditësi në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi: se edhe me tutje mbetet pranë padis dhe kërkesëpadisë se parashtruar, duke shtuar më tutja se nuk qëndron i vërtet fakti se kanë qenë më pagë sekondare nga viti 2015, e që në realitet është nga Marsi i vitit 2014, duke prezantuar para gjykatës si provë të gjitha listat nga 1 janari i vitit 2014 deri me 31.07.2015. Në rastin konkret nga e paditura është bërë shkelja e nenit 71 pika 1 . i Ligjit të Punës, në këtë nen ceket se njoftimi

paraprak për ndërprerjen e marrëdhënies së punës duhet të bëhet 30 ditë, të njëjtin afat e ka paraparë edhe kontrata e punës. Me tutja deklaroi se Universiteti përmes e-mailit, të datës ... i ka bashkangjitur njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës edhe pse afati ka qenë 30 ditor pretendon që kontrata i është ndërpre me 30 Maj 2017 dhe gjithsejtë nuk janë 30 ditë kohë po 26 ditë. Gjithashtu sipas paditësit përgjigja e dhënë nga ana e palës së paditur ka ngatërtime në nene duke mos i përkatur rastit konkret, gjithsejtë nga 165 të punësuar në stafin akademik kjo ndërprerje i ka afektuar gjashtë profesor bazuar në mendimin e Këshillit Drejtues të datës 31.03.2017, ku në arsyetimin e vendimit thuhet “një numër i konsiderueshëm i Universitetit Akademik punojnë diku tjetër”, kështu që numri 6 nga 165 konsiderohet se nuk është numër i konsiderueshëm. Në fjalën përfundimtare i propozon Gjykatës që padin dhe kërkespadinë e paditësit të e aprovoi si të bazuar ashtu si në Aktgjykimin e propozuar, shpenzimet e procedurës i kërkoi.

Përfaqësuesi i te paditurës në seancë kryesore dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se e kontestojnë padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar dhe konsiderojnë se vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës te paditësit është i bazuar konform dispozitave ligjore, statutit të Universitetit. E njëjta konsideron se nuk qëndrojnë të bazuara pretendimet e paditësit, sa i përket afatit prej 60 ditësh dhe se neni 70 pika 1 i Ligjit të Marrëdhënies së Punës, parasheh që punëdhënësi mund të ndërprej kontratën e punës në kohë të pa caktuar në bazë të nenit 70 të Ligjit të Punës në interval kohor të njoftimit paragrafi 1.3 mbi 10 vite punësim 60 ditë kalendarike. Lidhur me pretendimet e paditësit në vendimin e këshillit janë përcaktuar qartë kategoritë e mësimdhënësve të cilët kanë të drejtë të ruajnë marrëdhënien sekondare të punës pika 5 dhe mësimdhënësit të cilëve i'u ruhet vendi i punës pas skadimit të mandatit pika 4 dhe 5. Në bazë të pikës 3 të vendimit, pozita që mban paditësi në AKP është pozitë e lartë drejtuese por edhe kategori e shërbyesve civil, pozita që mban i njëjti në AKP nuk është funksion publik me mandatë të caktuar kohor por është edhe pozitë e lartë drejtuese në shërbimin Civil me akt-emërim të karrierës dhe në afat të pa caktuar. Ndërsa sa i përket afatit kohor të prapësuar nga paditësi theksoi se, në vendimin e këshillit të KD-së është paraparë afati prej 30 ditësh, bashk me shkresën e dërguar zyrës përgjegjëse për administratë nr.674 e datës 05.05.2017, është lënë edhe një muaj kohë 31 ditë njoftim, palët për tu deklaruar për pagesën primare, në të kundërtën i 'u ndërpritet marrëdhënia e punës. Në fjalën përfundimtare i propozon Gjykatës që padinë dhe kërkespadinë e paditësit të e refuzoi si të pa bazuar, shpenzimet e procedurës nuk i kërkoi.

Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik nxori dhe administroi këto prova materiale: Vendimi i te paditurës Nr.prot.... i datës ..., Vendimi i të paditurës Nr.... i datës ..., Njoftimi i të paditurës për zbatimin e vendimit të KD-së nr.... i datës .., Vendimi i të paditurës Nr.Prot..... i datës ..., Kontrata e Punës Nr.Prot... i datës ..., Akt Emërimi

Referenca ...MI 1 i datës ..., Vendimi i të paditurës Nr.Prot.... i datës ..., Llogaria nga BRK i datës ..., Diploma e fakultetit të Gjeoshkecape dhe Teknologjisë e datës ... e noterizuar, Diploma e Fakultetit të Xehtarisë dhe Metalurgjisë e datës ... me Nr..., E-mail Vendimi i KD-së për pagat e stafit akademik e datës ..., Njoftimi i stafit akademik për zbatimin e vendimit të KD-së nr.... i datës ... me Nr.prot.... i datës ..., E-mail i datës ..., Ankesa e paditësit e datës ..., Vendimi i të paditurës Nr.Prot.... e datës ..., Regjistri për deklarimin e pasurisë nga Agjencioni kundër korrupsionit, Kërkesa e të paditurit lidhur me kalimin në marrëdhënie të rregullt të punës me orara të shkurtër (pagë sekondare) ose ngrirje të pozitës së mësimdhënësit për afat të caktuar e datës ..., Deklarata për Akreditim për vitin akademik ... nga AKA(Agjencia e Kosovës për) e datës ... , Deklarata për Akreditim për vitin akademik ... nga AKA(Agjencia e Kosovës për) e datës ..., Deklarata për Akreditim për vitin akademik ... nga AKA(Agjencia e Kosovës për) e datës ..., Vendimi Nr.Prot.... e datës ..., E-maili lidhur me njoftimin e KD-së Nr.Prot.... e datës ..., E-maili për njoftimin e KD-së i datës ..., E-maili i datës ..., E-maili i datës ..., E-maili i datës ..., Kontrata e punës me honorar Nr.prot.... e datës ..., Llogaria nga BRK i datës ...

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Faktet jo Kontestuese:

Nuk është kontestues fakti se paditësi: **MH** ka lidhur kontratë pune me Universitetin e .. me kohëzgjatje deri me datë ..., e njëjta me rastin e transformimit nga Universiteti i ... në Universitetin e ..., paditësi ka kaluar në listën e pagave sekondare në Universitetin e .. kjo vërtetohet nga Kontrata e punës së paditësit dhe nga lista e pagave për muajin gushtë 2015. Për Gjykatën nuk është kontestuese fakti se Këshilli Drejtues i Universitetit bazuar në kompetencat e tij dhe në bazë të Ligjit të Punës, morri vendim që i gjithë personeli i stafit akademik në Universitetin e ...që ka marrëdhënie tjetër pune të përcaktohet nëse do të ketë marrëdhënie të rregullt pune me Universitetin apo jashtë Universitetit, ku i gjithë personeli kanë pasur afat që brenda 1 muaji për afërsisht 30 ditë të deklarohen se ku duan të përcaktohen për marrëdhënie të rregullt pune, në rast se nuk deklarohen për marrëdhënien primare të punës në Universitet, do të kalojnë si bashkëpunëtor të jashtëm, e cila vërtetohet në bazë të Vendimit Nr.Prot.... të datës ... dhe në bazë të njoftimit të publikuar në ëeb-faqen e UMIB-it datë ...

Nuk është kontestuese fakti se Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me datë ..., kërkoi nga Zyra përgjegjëse e administratës që të njoftoj gjithë personelin akademik, i cili deri në atë kohe nuk ishin deklaruar për pagë primare në Universitet, se deri me datë ... do t'iu ndërpritet kontrata e rregullt e punës, bazuar në vendimin Nr.... të datës ... dhe ku fakt vërtetohet nga shkresa Nr.... e datës ... e KD-së drejtuar administratës së Universitetit-it dhe nga e-maili zyrtar drejtuar personelit akademik.

Për Gjykatën nuk është kontestuese fakti se paditësit i është ndërpritur marrëdhënia e rregullt e punës me Universitetin e ... nga ana e të paditurit, duke e kaluar të njëjtin si bashkëpunëtor të jashtëm, kjo vërtetohet nga Vendimi Nr... i datës ...

Për Gjykatën nuk është kontestuese fakti se paditësit i është refuzuar ankesa drejtuar KD-së, lidhur me atë se paditësi ka pasur kontratë valide me Universitetin e ... dhe që nga viti ... ku është deklaruar për pagë sekondare në Universitetin e ... i është zvogëluar paga për 50%, e cila vërtetohet nga ankesa drejtuar KD-së kundër vendimit të ... i datës ... si dhe Vendimi mbi refuzimin e ankesës Nr.Prot.... e datës ...

Nuk është kontestuese fakti se Paditësi në AKP mban pozitë të lartë drejtuese, por është kategori e Shërbyesve Civil, kategori e pozitës e cila nuk është funksion publik me mandat të caktuar kohor, por është pozitë e lartë drejtuese në Shërbimin Civil me akt-emrim të karrierës dhe me afat të pacaktuar. Kjo vërtetohet nga Akt-emrimi i paditësit në AKP, Referenca ... 1 i datës ...

Për Gjykatën nuk është kontestuese se paditësi, është zgjedhur profesor i asocuar në Universitetin e ... dhe meqenëse i njëjti nuk është deklaruar për pagë primare në Universitetin e ..., i është ofruar kontrata e punës me honorar, kjo vërtetohet nga vendimi i Senatit Nr.1389 i datës 10.10.2018 dhe Kontrata e punës me honorar Nr.1654/13 i datës 02.11.2017.

Paditësi të drejtën e tij e mbështet në nenin 71 pika 2 e Ligjit të Punës ku thotë që (cituat): Punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës në kohë të pacaktuar në bazë të nenit 70, të këtij ligji në këto intervale kohore të njoftimit: 1.2. prej dy (2) deri në dhjetë (10) vite punësimi, dyzetepesë (45) ditë kalendarike, po ashtu thekson që në kontratën e lidhur me Universitetin parashihet afati 30 ditor para ndërprirjes së marrëdhënies së punës, po ashtu e njëjta parashihet edhe në shkresën dërguar zyrës përgjegjëse për administratë Nr.... e datës ... në të cilën theksohet se prej nxjerrjes së vendimit Nr.... e datës ... ka kaluar afati i deklarimit të Stafit akademik të Universitetit te ... për pagë primare.

Lidhur me pretendimet e lartëcekura gjykata sqaron faktin se ndërprerja e kontratës së paditësit është bërë në formë dhe në mënyrë të rregullt duke e

marr parasysh që neni 71 i ligjit të Punës par.1 cituar: “Punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës në kohë të pacaktuar në bazë të nenit 70, të këtij ligji në këto intervale kohore të njoftimit”, dhe në rastin konkret për paditësin është bërë paralajmërimi në kohë dhe në afate dhe e njëjta nuk ka bërë asnjë shkelje mbi bazën e së cilës të njëjtat kanë lidhur kontratë, duke vazhduar me tutje neni 71 par.1 i nën paragrafëve cituar “1.1. prej gjashtë (6) muaj deri në dy (2) vite punësim, tridhjetë (30) ditë kalendarike; 1.2. prej dy (2) deri në dhjetë (10) vite punësimi, dyzetepesë (45) ditë kalendarike; 1.3. mbi dhjetë (10) vite punësim, gjashtëdhjetë (60) ditë kalendarike”, të Ligjit të Punës në mënyrë decidive e parasheh rastet ku mund të ndërpritet marrëdhënia e punës në kohë të pacaktuar.

Pra sipas vlerësimit të gjykatës nuk ka shkelje të nenit 71 par.2 të Ligjit të Punës dhe se procedura e njoftimit ka qenë, barabartë e aplikuar për të gjithë dhe në rastin konkret nuk bëhet fjalë për shkelje të ndonjë afati ligjore ose për shkelje të kontratës.

Ndërsa sa i përket pretendimeve të paditësit lidhur me atë se po ashtu shkelja tjetër është se në piken 5 të vendimi Këshillit Drejtues datë 31.03.2017, është emërtuara gabim është postë politik ndërsa shkruan postë publike në piken 3 të të njëjtit, pretendimet e lartëcekua Gjykata i refuzoi si të pa bazuara dhe atë:

Sa i përket emërtimit gabim në nenin 5 postë politike gjykata duke u bazuar Vendimin Nr.Prot... e datës ..., me saktësisht pika 5 e Vendimit parasheh për të gjitha mësimdhënësit të cilët kanë të drejtë të e ruajnë marrëdhënien sekondare të punës si dhe pika 4 dhe 5 për të gjithë mësimdhënësit të cilët i'u ruhet vendi i punës pas skadimit të mandatit. Në rastin konkret paditësit i është ndërpre marrëdhënia e punës bazuar në piken 5 të Vendimit Nr.Prot... e datës ... dhe atë duke konsideruar se paditësi pozitën që e mban në AKP, është pozitë e lartë drejtuese po e njëjta bën pjesë në kategorinë e Shërbyesve Civil dhe i nënshtrohet Ligjit të Shërbyesve Civil, pozitë e cila me Akt-emrim është e pa përcaktuar në afat të karrierës dhe në afat të pacaktuar.

Po ashtu sa i përket pretendimeve të paditësit se kontrata me Nr,Prot.... e datës ... nuk është valide, gjykata gjeti se e njëjta nuk qëndron pasi që me rastin e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit vendimin e saj e bazoi edhe tek validiteti i kontratës me Universitetin e ... dhe që nga viti 2013 kur është deklaruar për pagë sekondare në Universitetin e ... i është zvogëluar paga në 50%, andaj kontrata me Nr.Prot.... e ... është valide dhe e njëjta është e bazuar, pasi që formulari për deklaram të pagës ka qenë bazë ligjore për të kaluar më pagë sekondare dhe në Universitetin e ..., ka kaluar me të drejta të plota sikurse që ka qenë në Universitetin e

Mbi bazën e vërtetuar të gjendjes faktike si me lart gjykata vlerësoi ligjshmërinë e procedurës së zbatuar nga e paditura dhe konstatoi se

procedura e zbatuar nuk është kundërligjore prandaj vendosi që, kërkesëpadinë e paditësit te refuzohet në tërësi **si të pabazuar**.

Vendimin që secila palë t'i bartë shpenzimet e procedurës, Gjykata e ka mbështetur në dispozitën nga neni 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Gjykata aktgjykimin e saj e bazoi ne nenin 143 par 1 te LPK-se.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.nr.431/2017 Datë: 07.06.2019

GJ Y Q T A R I
Ragip Kadriu

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtën e ankesës brenda afatit 15 ditor, që nga dita e pranimi, Gjykatës së Apelit të Kosovës, nëpërmes kësaj gjykate.